Mevlude Aliu-Gashi, Zehrie Plakolli
Bekim Morina, Sahare Reçica
Konsulent Ismet Potera
Instituti Pedagogjik i Kosovës
E-mail: mevlude.aliu@hotmail.com

### Abstrakt

Në edukimin parashkollor vitet e fundit janë bërë reforma të shumta, të cilat, në njëfarë mënyre, paraqitën nevojën të realizohet një hulumtim që pasqyron gjendjen aktuale.

Hulumtimi ka për qëllim të mbledhë të dhëna për arritjet e deritanishme në edukimin parashkollor/parafillor 0-6 vjeç dhe sfidat me të cilat ballafaqohet ky nivel i edukimit në Kosovë, duke përfshirë të gjitha institucionet e organizimit të tij (institucionet parashkollore publike, private, qendrat me bazë në komunitet dhe klasat parafillore në kuadër të shkollave).

Projekti trajton aspekte të ndryshme të edukimit parashkollor, si: Korniza ligjore dhe administrative; përmbajtja dhe cilësia e programeve, materialet didaktike dhe tekstet në edukim parashkollor/parafillor; menaxhmenti, edukatoret dhe bashkëpunëtorët profesionalë; gjithëpërfshirja në edukimin parashkollor;

## Preschool Education in Kosovo - Achievements and Challenges

Mevlude Aliu-Gashi, Zehrie Plakolli
Bekim Morina, Sahare Reçica
Ismet Potera, Consultant
Kosovo Pedagogical Institute
E-mail: mevlude.aliu@hotmail.com

### Abstract

In recent years, numerous reforms have been made in preschool education, which, in a way, presented the need to conduct research that reflects the current situation.

The research aimed to collect data on the achievements in preschool / pre-primary education 0-6 years and the challenges faced by this level of education in Kosovo, including all institutions of its organization (public and private preschool institutions, community-based centers and pre-primary classes within schools).

The project addressed various aspects of preschool education, such as: Legal and administrative framework; content and quality of programs, didactic materials and textbooks in preschool / pre-primary education; management, educators and professional associates; inclusion in preschool education; welfare

mirëqenia, shëndeti dhe ushqimi për fëmijët në institucione parashkollore/parafillore; mjedisi dhe kushtet e objekteve parashkollore në të cilat realizohet qëndrimi ditor i fëmijëve, qëndrimi gjysmë-ditor dhe me orar të caktuar.

Hulumtimi është përshkrues dhe vlerësues, i cili karakterizohet nga qasja sasiore dhe cilësore. Përfshin institucionet që merren me edukimin parashkollor/parafillor, prandaj mblidhen të dhënat se si realizohet puna dhe cilat janë përparësitë, mangësitë dhe sfidat me të cilat ballafaqohen realizuesit e këtij edukimi.

Hulumtimi përfshin Divizionin për edukim parashkollor dhe Divizionin për arsim privat në MASH, DKA-të e 7 komunave, 15 institucione parashkollore publike, 20 institucione parashkollore private, 20 klasa parafillore në shkolla dhe 3 qendra me bazë në komunitet.

Janë hartuar instrumentet e hulumtimit: Intervista për zyrtarë të MASH-it; pyetësori për zyrtarë të Drejtorive Komunale, pyetësori për drejtorë të institucioneve

Në bazë të rezultateve të marra nga terreni, do të dalin rekomandimet për MASH-in, DKA-të, menaxhmentin e institucioneve parashkollore (publike dhe private), për edukatoret e këtyre institucioneve dhe klasave parafillore, me qëllim që të ndihmojnë institucionet përgjegjëse dhe të gjithë aktorët në përmirësimin e gjendjes së edukimit parashkollor në Kosovë.

**Fjalët çelës**: edukim parashkollor/parafillor, edukatore, fëmijë, publike, private

health and nutrition for children in preschool / pre-primary institutions; the environment and children daily stay conditions of the preschool facilities, the half-day stay, and the fixed Schedule.

This research is descriptive and evaluative employing quantitative and qualitative approaches. The institutions that deal with preschool / pre-primary education were included, therefore data were collected on how the work is done and what are the advantages, shortcomings and challenges faced by the implementers of this education. It was also included the Division for preschool education and the Division for private education in MES, MEDs of 7 municipalities, 15 public preschool institutions, 20 private preschool institutions, 20 pre-primary/preparatory classes in schools and three community-based centers. The following research instruments were used: Interviews for MES officials; questionnaire for officials of Municipal Directorates, questionnaire for principals of preschool institutions, community-based centers, and educators.

Based on the results obtained on-site, recommendations will be issued for MES, MEDs, management of preschool institutions (public and private), for educators of these institutions and pre-primary classes, in order to help responsible institutions and all actors in improving the situation of preschool education in Kosovo.

**Keywords*:*** preschool / pre-primary education, educator, children, public, private.

## Mësimdhënësi si hulumtues dhe avokues

***Vëzhgimi, dokumentimi dhe të drejtat e fëmijëve***

Saameh Solaimani, Ed.M., Universiteti Harvard
Specialiste, profesoreshë, konsulente, hulumtuese dhe avokuese e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme

Prezantimi jep një pasqyrë të konceptit të 'mësimdhënësit si hulumtues', përmes vëzhgimit dhe dokumentimit, dhe një skicë se si vëzhgimet e qëllimshme dhe sistematike, si dhe praktikat e dokumentimit, mund të përdoren për të kuptuar më mirë mësimdhënien dhe të nxënit. Këto koncepte janë bazë për mbështetjen e praktikave të qëllimshme në zhvillimin e kurrikulës, vlerësimin e mirëfilltë, praktikat reflektuese, komunikimin, dhe angazhimin në kontekstet e edukimit në fëmijëri të hershme.

Gjithashtu, prezantimi do të mbështesë të kuptuarit më të gjerë se si këto strategji mund të përdoren për të krijuar partneritet me fëmijët, familjet dhe profesionistët e tjerë, me qëllim të ndikimit pozitiv në zhvillimin dhe të nxënit e fëmijëve.

Eksplorimi i këtyre koncepteve, bazuar në filozofinë e edukimit Reggio Emilia, mundëson të kuptuarit më të thellë të elementeve themelore të dokumentimit në edukimin për fëmijëri të hershme dhe rëndësinë e tij në sigurimin e të drejtave themelore të fëmijëve, të cilat garantojnë të bërit të dukshëm dhe të dëgjuar të fëmijëve

## Teacher as Researcher and Advocate

***Observation, Documentation and Children's Rights***

Saameh Solaimani, Ed. M., Universitet Harvard

This presentation will provide an overview of the concept of "teacher as researcher" through observation and documentation and an outline for how intentional and systematic observation and documentation practices can be used to gain a deeper understanding of teaching and learning. These concepts are foundational in supporting intentional practice in curriculum development, authentic assessment, reflective practice, communication, and engagement in early childhood education settings. Additionally, this presentation will support further understanding of how these strategies can be used to partner with children, families and other professionals, to positively influence children's development and learning.

Exploration of these concepts, with foundations rooted in the Reggio Emilia philosophy of

education, will support a deeper understanding of the fundamentals of documentation in early

childhood education and it's importance in ensuring children's basic right to be seen and heard.

## Temat dhe motivet në tekstet e Leximit letrar (VI-IX) të gjuhës boshnjake dhe pajtueshmëria e tyre me Kurrikulën e Republikës së Kosovës

Belkiz Lalosh

Qëllimi i këtij punimi është analiza e teksteve shkollore Lexim letrar për klasat VI-IX në gjuhën boshnjake dhe pajtueshmëria e temave dhe motiveve me Kurrikulën e re të Kosovës.

Fokusi i analizës së teksteve shkollore Lexim letrar janë motivet kryesore të prezantuara në formë krijimesh letrare: në prozë, poezi apo letërsi popullore, ndikimi dhe përshtatshmëria, kompatibiliteti i tyre me kërkesat dhe parimet e Kurrikulës. Gjithashtu, do të analizohet edhe fondi i orëve të përgjithshme në këto klasë dhe shtrirja e përfaqësimit të gjuhës boshnjake në to.

Metoda e zbatuar për realizimin e këtij studimi është analiza dhe krahasimi cilësor i përmbajtjeve që përfaqësojnë motivet dhe temat kryesore në këto tekste.

Rezultatet e kësaj analize do të ndihmojnë hartimin e politikave dhe përzgjedhjen e përmbajtjeve dhe motiveve letrare në gjuhën boshnjake. Rekomandimet janë të mirëseardhura për autorët dhe zbatuesit e këtyre teksteve në harmoni me Kurrikulën e Kosovës.

**Fjalët çelës:** lexim letrar, motive letrare, pajtueshmëri, kurrikulë.

## Topics and motives in the text of the Bosnian language Literary Reading (VI-IX) and their compatibility with the Curriculum of the Republic of Kosovo

Belkiz Lalosh

The purpose of this paper is the analysis of Literary reading textbooks for grades VI-IX in the Bosnian language and the compatibility of topics and motives with the new Kosovo Curriculum.

The focus of the Literary reading textbook analysis are the main motives presented in the form of literary creations: in prose, poetry or popular literature, their influence and appropriateness, their compatibility with the requirements and principles of the curriculum. The general classes fund of hours in these grades and the extent of Bosnian language representation in them will also be analysed.

The analysis and qualitative comparison of the contents that represent the key motivations and topics in these texts will be used for the conduct of this study.

The fidnings might help design policies and select literary content and motifs in the Bosnian language. Recommendations are welcome for the authors and implementers of these textbooks in line with the Kosovo Curriculum.

**Keywords:** literary reading, literary motives, compliance, curriculum.

# Niveli i të kuptuarit të tekstit të lexuar te nxënësit me dëmtime në dëgjim

Luljeta Kabashi, master i arsimit gjithëpërfshirës
*Ministria e Arsimit dhe e Shkencës,*
luljeta.kabashi@gmail.com
Ahmet Mahmutaj, master i arsimit gjithëpërfshirës
*Qendra Burimore për mësim dhe këshillim "Nënë Tereza" në Prizren,* amahmutaj@gmail.com

## Abstrakt

Dëmtimi i dëgjimit është i njohur se ndikon fillimisht në zhvillimin e të folurit te fëmijët dhe më pastaj në shkathtësitë si leximi dhe shkrimi. Për më shumë, vonesat në përvetësimin e këtyre shkathtësive janë pengesë evidente për shkollimin e tyre. Qëllimi i hulumtimit është të konstatojë nivelin e të kuptuarit të tekstit të lexuar te fëmijët me dëmtime në dëgjim në shkolla të rregullta, dhe të krahasojë nivelin e të kuptuarit të tekstit të lexuar ndërmjet nxënësve në Qendra Burimore dhe klasë të rregullta. Kemi hulumtuar nivelin e të kuptuarit të tekstit të lexuar te 32 nxënës/e me dëmtime në dëgjim dhe kohën e nevojshme për lexim, duke përdorur dy lloje të pyetjeve, të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Nga Qendra Burimore kanë marrë pjesë 16 nxënës/e nga klasa 6-9 dhe 10-12, dhe 16 nxënës në shkolla të rregullta në të njëjtat klasë, të cilët kanë dëmtim në dëgjim. Materiali hulumtues i pa standardizuar përbëhet prej 14 teksteve të

# The Level of Comprehension of the Reading Text of Students with Hearing Impairments

Luljeta Kabashi, Master of Inclusive Education
*Ministry of Education and Science,*
luljeta.kabashi@gmail.com
Ahmet Mahmutaj, Master of Inclusive Education
*"Mother Teresa" Resource Center for teaching and counseling in Prizren,,* amahmutaj@gmail.com

## Abstract

It is understood that hearing impairment affects the development of speech in children first and then skills such as reading and writing. In addition, delays in acquiring these skills are an obvious barrier to their education. The purpose of the study was to evaluate the level of understanding of the reading text in standard schools by children with hearing impairments, and to compare the level of understanding of the text between the students in the Resource Center and the regular classroom.

Using two forms of questions, direct and indirect, we surveyed the degree of understanding of the reading in 32 students with hearing impairments and the time needed for reading. The Resource Center involved 16 students from grades 6-9 and 10-12, and 16 students with hearing impairment at regular schools in the same grades. The non-standardized study material in the "Reading Book" consists of 14 short texts, which vary according to class, with a

shkurtra në ‘Libër Leximi’, që ndryshojnë sipas klasës, me gjithsej 70 pyetje me përgjigje të shumëllojshme. Secili nxënës t’i lexojë 2 tekste të shkurtra dhe do t’i përgjigjet 10 pyetjeve. Hulumtimi tregoi se përgjigjet në pyetjet e drejtpërdrejta ishin me rezultate më të mira, në raport me ato të tërthorta, dhe kjo tregon përvetësimin joadekuat të shkathtësive në lexim. Nxënësit në Qendra Burimore kanë treguar rezultate më të dobëta në lexim, në të gjitha pyetjet hulumtuese, përveç në kohën e zgjidhjes, në raport me bashkëmoshatarët me dëmtime në dëgjim në shkolla të rregullta. Nxënësve në Qendra Burimore u duhet më shumë nxitje për zhvillimin e shkakësisë në lexim, si programet jashtë mësimorë të gjuhës. Rezultat tjetër i hulumtimit është se të kuptuarit e tekstit të lexuar si dhe përfundimi logjik te nxënësit me dëmtime në dëgjim është në nivel të ulët.

**Fjalët çelës***:* dëmtimet në dëgjim, leximi, të kuptuarit.

total of 70 questions with multiple-choice answers

Each student read two short texts and answered ten questions. The study found that compared to the indirect ones, the responses to the direct questions had better results, and this indicates the insufficient development of reading skills. On all study questions, students at Resource Centers have achieved lower reading scores, even at the time of answering, compared to peers with hearing impairment in regular schools. The students of Resource Center need more incentives, such as language extracurricular programs to improve reading skills. Another finding of the analysis is that the comprehension of the reading text is at a poor level, as is the logical conclusion of students with hearing impairments.

**Keywords:** hearing impairments, reading, comprehension.



**Seanca 2: Zhvillimi profesional i mësimdhënësve dhe mësimi online**
**Session 2. Professional development of teachers and online learning**
**Moderator: Ismet Potera**

## Kompetencat pedagogjike të mësimdhënësve të shkollave të mesme të larta në Kosovë

**Agim Bujari**
*Instituti Pedagogjik i Kosovës*
*E-mail: agim.bujari@rks-gov.net*
*agim.bujari@gmail.com*

### Abstrakt

Kompetenca pedagogjike e mësimdhënësve është aftësia për të menaxhuar mësimin, gjegjësisht klasën dhe orën mësimore, e cila përfshin planifikimin, implementimin dhe vlerësimin e rezultateve të të nxënit të nxënësve. Kompetencat pedagogjike: njohuritë, aftësitë, shprehitë, si dhe mënyrat dhe mjetet e realizimit të aktivitetit në komunikim, zhvillim dhe vetëzhvillim të personalitetit, duhet t'i zotërojë çdo mësimdhënës.

Qëllimi i studimit të kësaj teme është të konstatohet cilat kompetenca pedagogjike i zotërojnë mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta.

Popullacionin e hulumtimit e përbëjnë të gjithë mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta në Kosovë, kurse grupin përfaqësues e përbëjnë 270 mësimdhënës. Mënyra e pjesëmarrjes së mësimdhënësve është e rastësishme.

## Pedagogical competencies of high school teachers in Kosova

**Agim Bujari**
*Kosovo Pedagogical Institute*
*E-mail: agim.bujari@rks-gov.net*
*agim.bujari@gmail.com*

### Abstract

Teachers' pedagogical competence is the ability to manage the lesson, i.e., the classroom and the lesson, including planning, implementing, and evaluating students' learning outcomes. Pedagogical competencies: knowledge, skills, habits, and ways of carrying out the activity in communication, development, and self-development of the personality should be possessed by every teacher.

The purpose of this study was to analyze the pedagogical competencies of high school teachers.

The research population were high school teachers of Kosovo, while the representative group consisted of 270 high school teachers selected randomly.

The study employed a quantitative research approach and a questionnaire based on Likert scale. Data analysis was done through the SPSS 21 pro-

Studimi është i natyrës sasiore, prandaj, për realizimin e tij, si instrument është përdorur pyetësori për mësimdhënës, i shkallës Likert. Analiza e të dhënave është bërë përmes programit SPSS 21. Për realizimin e punimit, janë zbatuar metoda e analizës së dokumentacionit, metoda statistikore dhe metoda krahasuese. Përmes pyetjeve janë marrë opinionet e mësimdhënësve për kompetencat pedagogjike që i zotërojnë dhe njëkohësisht është përmbushur qëllimi i hulumtimit.
Bazuar në rezultatet e përgjithshme, 88.7% e mësimdhënësve konsiderojnë se kanë kompetenca të larta pedagogjike, 8.3 % konsiderojnë se kompetencat e tyre janë në nivelin mesatar, ndërsa 3 % konsiderojnë se i kanë në nivel të ulët. Mesatarja e përgjithshme, M=4.4. Rezultatet empirike vërtetuan se ka dallime në zotërimin e kompetencave pedagogjike nga ana e mësimdhënësve. Këto rezultate treguan se mesataren më të lartë për kompetencat pedagogjike e kanë mësimdhënësit e gjimnazeve, M=141.05, pastaj mësimdhënësit e shkollave profesionale, M=139.53, ndërsa mesataren më të ulët e kanë mësimdhënësit e shkollave të kombinuara, M=98.93, vlera e $X^2$=7.438, p=0.024<0.05.
Rezultatet empirike dëshmojnë se mësimdhënësit kanë vetëbesim të lartë për kompetencat e tyre pedagogjike. Mësimdhënësit e gjimnazeve nivelin e kompetencave pedagogjike e kanë më të lartë se mësimdhënësit e shkollave profesionale dhe shkollave të kombinuara. Rezultatet e hulumtimit tregojnë nivel më të lartë të kompetencave për përdorimin e TIK nga mësimdhënësit e moshës më

gram. The documentation analysis method, statistical method, and comparative method were applied for the accomplishment of the work.

Through the questions, the opinions of the teachers were obtained about the pedagogical competencies they possess, and at the same time, the purpose of the research was fulfilled.
Based on the overall results, 88.7% of teachersconsider that they have high pedagogical competencies, 8.3% consider that their competencies are at the average level, while 3% consider that they have them at a low level. Overall average was M = 4.4. The empirical results proved that there is significance in the mastery of pedagogical competencies by teachers. These results showed that teachers of gymnasiums have the highest average for pedagogical competencies, M = 141.05, then vocational school teachers, M = 139.53, while combined school teachers have the lowest average has M = 98.93, the value of X2 = 7.438, p = 0.024 <0.05.

Empirical results show that teachers have high self-confidence in their pedagogical competencies. Gymnasium teachers have a higher level of pedagogical competencies than teachers of vocational schools and combined schools. The research results indicate a higher level of competencies for the use of ICT by younger teachers and a higher mastery of pedagogical com-

të re, si dhe zotërim më të lartë të kompetencave pedagogjike nga mësimdhënësit e gjinisë femërore. Mësimdhënësit tregojnë nivel të lartë të kompetencave pedagogjike, të cilat u ndihmojnë atyre të menaxhojnë me sukses procesin mësimor, duke filluar nga planifikimi deri në procesin e vlerësimit të nxënësve.

**Fjalët çelës:** kompetencë, pedagogjike, mësimdhënës, shkollë e mesme e lartë

petencies by female teachers.

It can be concluded that teachers show a high level of pedagogical competencies, which help them successfully manage the learning process, from planning to the student assessment process.

**Keywords*:*** competence, pedagogy, teacher, high school

## Perceptimet e mësimdhënësve për përgatitjen e tyre për të kuptuar dhe zbatuar standardet e profesionit të mësimdhënies

Egzona Spahiu

Abstrakt

Ky hulumtim shqyrton nivelin e zbatimit të standardeve të profesionit të mësimdhënies nga mësimdhënësit, shfaq perceptimet e mësimdhënësve për të kuptuarit e standardeve të profesionit të tyre, si dhe identifikon faktorët që ndikojnë në përgatitjen e mësimdhënësve për standardet e mësimdhënies.

Perceptimet, si dhe përvojat e mësimdhënësve në këtë studim, paraqesin një bazë të mirë për reformimin e cilësisë së programeve të studimit dhe trajnimeve profesionale. Me anë të tyre, adresohet nevoja që në të ardhmen përgatitja e mësimdhënësve të bëhet krahas standardeve të profesionit të mësimdhënies. Hulumtimi adreson këto pyetje hulumtuese: *Si i kuptojnë mësimdhënësit standardet e profesionit të mësimdhënies? Sa i zbatojnë mësimdhënësit standardet e profesionit të mësimdhënies? Cilët janë faktorët që ndikojnë në përgatitjen e mësimdhënësve për standardet e profesionit të mësimdhënies?*

Natyra e hulumtimit është cilësore dhe sasiore. Stu-

## Teachers' Perceptions of their Preparation to Understand and Apply the Standards of the Teaching Profession

Egzona Spahiu

Abstract

This research explores the level of implementation of teaching profession standards by teachers, it displays teachers' perceptions of understanding their profession standards, and identifies the factors that affect teachers' preparation for teaching standards.

In this study, the perceptions and experiences of teachers represent a good basis for reforming the quality of study programs and vocational training. Through them, the need is addressed that in the future the preparation of teachers should be done along with the standards of the teaching profession. The research addressed these research questions: *How do teachers understand the standards of the teaching profession? How well do teachers apply the standards of the teaching profession? What are the factors that affect the preparation of teachers for the standards of the teaching profession?*

The nature of the research is qualitative and quantitative. The study was conducted in the primary schools and 360 teachers were surveyed,

dimi është realizuar me anketimin e 360 mësimdhënësve dhe me intervistimin e 8 mësimdhënësve të ciklit fillor. Instrumentet për mbledhjen e të dhënave janë pyetësori gjysmë i strukturuar dhe intervista gjysmë e strukturuar. Të dhënat sasiore u analizuan përmes programit SPSS, ndërsa të dhënat cilësore përmes qasjes së analizës tematike.

Rezultatet e fituara nga ky studim tregojnë se në përgjithësi mësimdhënësit i zbatojnë standardet e profesionit të mësimdhënies. Analizat e bëra kanë rezultuar me dallime ndërmjet grupeve të caktuara të mësimdhënësve, pasi $p < .05$ për nivelin e zbatimit të këtyre standardeve. Dallime domethënëse janë shqyrtuar edhe ndërmjet grupeve të mësimdhënësve, për identifikimin e faktorëve për ngritje profesionale. Analiza tematike ka pasqyruar këndvështrime të ndryshme, rreth të kuptuarit të standardeve nga ana e mësimdhënësve, mirëpo jo dhe aq devijuese nga koncepti, që në realitet njihen dhe përkufizohen standardet e mësimdhënies.

**Fjalët çelës:** perceptimet e mësimdhënësve, përgatitja e mësimdhënësve, profesioni i mësimdhënies, kuptimi i standardeve, zbatimi i standardeve.

and eight teachers were interviewed. A semi-structured questionnaire and a semi-structured interview were used for data collection. The quantitative data were analysed through the SPSS program, while qualitative data through the thematic analysis approach.

The results obtained from this study show that teachers generally apply the standards of the teaching profession. The findings indicate differences between certain groups of teachers with $p <.05$ for the level of implementation of these standards. Significant differences were also examined between groups of teachers, to identify factors for professional development. Thematic analysis has reflected different perspectives on teachers' understanding of standards, but not so deviant from the concept how teaching standards are recognized and defined.

**Keywords*:*** teachers' perceptions, teacher preparation, teaching profession, understanding of standards, implementation of standards

## Perceptimet e mësimdhënësve ndaj procesit të vlerësimit të performancës

Ismet Potera[1] & Selim Mehmeti[2]

### Abstrakti

Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve është një proces i rëndësishëm dhe i ndjeshëm. Mësimdhënësit dhe inspektorët shfaqin perceptimet e tyre për procesin e vlerësimit nga këndvështrime të ndryshme. Këto perceptime janë objekt i këtij hulumtimi. Qëllimi i hulumtimit është marrja dhe analiza e perceptimeve të mësimdhënësve dhe inspektorëve për procesin dhe ndjeshmërinë e vlerësimit. Si çështje me rëndësi ishin: çështjet emocionale të procesit, përmbajtja e vlerësimit, si dhe pritjet që ata kishin nga ky proces. Qasja hulumtuese është cilësore, me një mostër prej 16 mësimdhënësish, të cilët kanë qenë pjesë e vlerësimit, si dhe pesë inspektorë, të cilët kanë qenë pjesë e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve. Intervista me shkrim është përdorur me gjashtë pyetje të hapura. Përpunimi i të dhënave është bërë sipas parimeve të qasjes cilësore, të promovuar nga Creswell (2007). Rëndësia e hulumtimit qëndron në të kuptuarit e përvojave dhe njohurive më të thelluara, sa u përket ndjeshmërisë dhe rëndësisë, që ka vlerësimi i performancës së mësimdhënësve. Kjo do ta ndihmojë avancimin e këtij procesi, si dhe praktikën e vlerësimit në të ardhmen.

**Fjalët çelës**: informim, qëndrim, stres, pakënaqësi, pritje, frikë, zhvillim. profesional

## Teachers' perceptions of the performance appraisal process

Ismet Potera & Selim Mehmeti

### Abstract

Evaluating teacher performance is an important and sensitive process. Teachers and inspectors express their perceptions of the assessment process from different perspectives. These perceptions are the object of this research. The purpose of the research was to obtain and analyze the perceptions of teachers and inspectors about the assessment process and sensitivity. As important issues were: the emotional issues of the process, the content of the evaluation as well as the expectations they had from this process. The research approach is qualitative with a sample of 16 teachers who were part of the evaluation, as well as 5 inspectors as evaluators. The written interview was used, with six open-ended questions. Five inspectors who were part of the teacher performance appraisal were also inter-viewed. Data processing is done according to the principles of the qualitative approach promoted by Creswell (2007). The importance of research lies in understanding the deeper experiences and knowledge in terms of the sensitivity and importance of evaluating teacher performance. This will help advance this process as well as the evaluation practice in the future.

**Keywords**: information, attitude, stress, dissatisfaction, expectation, fear, professional development.

[1] Hulumtues në IPK

[1] Hulumtues në IPK

## REKOMANDIMET

Mësimdhënësit tregojnë se kanë mungesë të informimit lidhur me përmbajtjen dhe procesin e vlerësimit të performancës së tyre. Prandaj IA, MASH, DKA dhe menaxhmenti i shkollës duhet të bëjnë më shumë në drejtim të adresimit të kësaj mungese, si: informimi i rregullt i mësimdhënësve për përmbajtjen e vlerësimit, procedurat e vlerësimit dhe kriteret e vlerësimit, por edhe vetëdijesimi i tyre për rëndësinë e vlerësimit të performancës për mësimdhënësin, nxënësit dhe sistemin e arsimit në përgjithësi.

Rekomandohet më shumë përgatitje dhe përgjegjësi profesionale nga mësimdhënësit, drejtorët e shkollave dhe inspektorët vlerësues të performancë së mësimdhënësve, në mënyrë që vlerësimi të jetë real, objektiv dhe i bazuar në standarde ndërsa veprimet të kenë karakter zhvillimor për mësimdhënësit, nxënësit, shkollën dhe përgjithësisht sistemin arsimor parauniversitar.

Raporti përfundimtar i vlerësimit duhet të jetë bindës dhe i argumentuar për secilin aspekt të vlerësimit. Para se të nënshkruhet raporti nga ana e të vlerësuarit, duhet të zhvillohet analizë dypalëshe me qëllim të argumentimit dhe arsyetimit të secilit aspekt të vlerësuar. Rekomandimet duhet të jenë pajtim i përbashkët duke adresuar nevojat zhvillimore të mësimdhënësit (sipas rastit edhe të afatizuara).

## RECOMMENDATIONS

Teachers indicate that they lack information about the content and the process of evaluating their performance. Therefore, EI, MES, MED, and school management should do more to address this shortcoming, such as regular information of teachers about the content of assessment, assessment procedures and criteria, but also their awareness of the importance of performance evaluation for the teacher, students and the education system in general.

More professional preparation and responsibility are recommended by teachers, school principals, and teacher performance evaluation inspectors so that the evaluation is realistic, objective, and based on standards. Simultaneously, the actions have a developmental character for teachers, students, the school, and the pre-university education system in general.

The final evaluation report should be convincing and well-constructed for each aspect of the evaluation. Before the evaluator signs the report, a bilateral analysis should be conducted to construct and justify each aspect of the evaluation. Recommendations should be mutually agreed upon addressing the teacher's developmental needs (as appropriate also time-bound). The issue of teacher

Çështja e përgatitjes së mësimdhënësve për mësimdhënie, materiale mësimore, teknike dhe metodike duhet të bëhet pjesë e kulturës së punës së përditshme të mësimdhënësve, jo vetëm gjatë procesit të vlerësimit. Drejtorët e shkollave duhet të punojnë më shumë në zhvillimin profesional të mësimdhënësve, sidomos në fushën e kompetencës profesionale dhe pedagogjike të tyre. Në rekomandime nuk hasëm në sugjerime për hartimin e planit për zhvillim dhe për përmirësim gradual të mangësive të gjetura gjatë vlerësimit.

Vlerësimin e brendshëm duhet ta zbatojnë jo vetëm si një akt administrativ, dhe subjektiv, por si mundësi për identifikimin e nevojave të mësimdhënësve për zhvillim profesional në koherencë me kërkesat e kohës.

Inspektorët e arsimit, vlerësuesit, duhet të jenë në nivel të përgatitjes pedagogjike dhe profesionale duke hequr çdo dilemë ose dyshim te mësimdhënësit për kompetencën e tyre vlerësuese. Duhet të tregojnë konsistencë në vlerësimin e tyre verbal dhe me shkrim, ndërsa vlerësimi të jetë në funksion të zhvillimit dhe të përsosjes profesionale e pedagogjike të mësimdhënësve.

preparation for teaching, teaching materials, technical and methodological should become part of the culture of teachers' daily work, not only during the assessment proces. School principals need to work harder on teachers' professional development, especially in the area of their professional and pedagogical competence. In the recommendations, we did not find any suggestions for drafting a development plan and for a gradual improvement of the shortcomings found during the evaluation.

Internal evaluation should be implemented as an administrative and subjective act and an opportunity to identify teachers' professional development needs in coherence with the requirements of the time.

Education inspectors should be at the level of pedagogical and professional preparation, removing any dilemma or doubt from teachers about their evaluative competence. They must show consistency in their verbal and written assessment, while the assessment must be in function of the development and professional and pedagogical perfection of teachers.

## Efektet e mësimit online te studentët e Fakultetit të Edukimit në Gjilan gjatë pandemisë Covid-19

Voglushe Kurteshi[3]
Liridona Mehmeti[4]
Rina Rasimi[5]

### Abstrakti

Ky studim u përqendrua në përvojat e të mësuarit online te studentët e Fakultetit të Edukimit pas përfundimit të ligjëratave. Për këtë kërkim, kemi përdorur dizajnin fenomenologjik kuantitativ, në të cilin kanë marrë pjesë 137 studentë, me ç`rast kemi përpiluar një pyetësor elektronik në Google forms, të shpërndarë në grupe të studentëve, me anë të të cilit kemi marrë qëndrimet e tyre rreth mbajtjes së mësimit gjatë semestrit veror 2019/20. Pyetësori është i përbërë prej 16 pyetjeve, 15 të mbyllura dhe një e hapur.

Hulumtimi ka për qëllim të zbulojë efektet dhe vështirësitë në përvojën e re të mësimdhënies dhe të të nxënit gjatë kohës së pandemisë.

Në bazë të përgjigjeve të studentëve, lidhur me përvojën paraprake për mësimin online, (51.5%) e tyre kanë deklaruar se aspak nuk kanë pasur për-

[3] Universiteti Publik „**Kadri Zeka**“ Gjilan
[4] Universiteti Publik „**Kadri Zeka**“ Gjilan
[5] Universiteti Publik „**Kadri Zeka**“ Gjilan

## The effects of online learning on the students of the Faculty of Education in Gjilan during the COVID-19 pandemic

Voglushe Kurteshi[5]
Liridona Mehmeti[6]
Rina Rasimi[7]

### Abstract

This study focused on the Faculty of Education students’ online learning experiences after the summer semester’s lectures. For this research, the quantitative phenomenological design was used, with a sample of 137 students. An electronic questionnaire via Google forms was distributed to the groups of participants, through which the views about the online teaching process during the summer semester 2019/20 were obtained. The questionnaire consisted of 16 questions, 15 closed and one opened.

The research aimed to reveal the effects and difficulties of the new teaching and learning experience during the pandemic.

Based on the students’ answers regarding the previous online learning experience, (51.5%) stated that they had no experience at all, while how

5,6,7 Universiteti Publik „**Kadri Zeka**“ Gjilan

vojë, ndërsa si i janë përshtatur kësaj forme të të mësuarit përqindja më e madhe e studentëve (35.3%) e vlerësojnë atë si një vlerë mesatare. Mirëpo, se sa ka qenë efektive mësimdhënia online, studentët kanë deklaruar kështu: (36%) janë përgjigjur se kanë pasur probleme teknike, mungesë të internetit, pajisjeve digjitale, gjithashtu motivimi i studentëve është vlerësuar mesatarisht apo (37.5%). Kurse, në pyetjen e hapur, se cilat ishin vështirësitë, ata kanë radhitur një varg sosh, si: mungesa e ndërveprimit, e internetit, e rrymës, e pajisjeve teknologjike, e tabelës, e përqendrimit, si dhe monotonia gjatë ligjëratave etj.

**Fjalët çelës**: mësimi online, studentë, pajisje teknologjike, vështirësitë, pandemi.

did they adapt to this form of learning the largest percentage of students (35.3%) rated it as an average value. However, on the question: how effective was online teaching, students stated as follows: (36%) answered that they had technical problems, lack of Internet coverage, lack of digital equipment, student motivation was rated average or (37.5%). Whereas, in the open question regarding the difficulties during the online learning, they listed several difficulties which they encountered during the online learning such as lack of interactivity, Internet issues, electricity problems, lack of technological equipment, lack of boards, less concentration, and distracting problems, as well as monotony during lectures, and other issues.

**Keywords*:*** online learning, students, technological equipment, difficulties, pandemic.

**Qëndrimet e studentëve të Universitetit "Ukshin Hoti" ndaj mësimit online**

Fatmir Mehmeti[6] & Hysen Balaj[7]

Ky punim ka për qëllim identifikimin e qëndrimeve të studentëve të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren lidhur me mësimin online. Gjithashtu, punimi ka për qëllim të përcaktojë nëse qëndrimet ndryshojnë në varësi të gjinisë, vendbanimit të studentëve, mjeteve të përdorura përgjatë mësimit online, si dhe programit të studimeve. Për problemin e përzgjedhur nga qasja kuantitative (sasiore) është përdorur metoda deskriptive - kërkimore. Mostra është përbërë nga 254 studentë, të cilët ndjekin studimet në vitin akademik 2020-2021, në Fakultetin e Edukimit, Fakultetin Juridik, si dhe Fakultetin Ekonomik. Për grumbullimin e të dhënave të mjaftueshme për hulumtimin e problemit, përdorëm teknikën e anketës me instrumentin e saj, pyetësorin. Pyetësori i përket tipit Likert, i përbërë nga pesë shkallë, "Plotësisht nuk pajtohem", "Nuk pajtohem", "I pavendosur", "Pajtohem" dhe "Plotësisht pajtohem". Të dhënat e mbledhura janë bartur në programin Statistical Program for Social Sciences (SPSS) v.25 dhe janë përpunuar. Për të analizuar se a ekzistojnë dallime ndërmjet qëndrimeve të studentëve lidhur me mësimin online, gjinisë, vendbanimit të studentëve, si dhe

[6] Profesor në Universitetin Ukshin Hoti,
[7] Drejtor shkolle, kandidat I PhD

**Attitudes of "Ukshin Hoti" University Students towards Online Learning**

Fatmir Mehmeti[8] & Hysen Balaj[9]

This paper aimed to identify the attitudes of students of the "Ukshin Hoti" University in Prizren regarding online learning. The paper also intended to determine whether attitudes vary depending on gender, student residence, tools used throughout online learning, and the curriculum. For the problem selected from the quantitative approach, descriptive-research method was used. The sample consisted of 254 students, who are currently studying in the 2020-2021 academic year, at the Faculty of Education, the Faculty of Law, and the Faculty of Economics. To collect enough data to research the problem, we used the survey technique i.e., the questionnaire. The questionnaire, the Likert type, consisting of five scales, "Strongly Disagree", "Disagree", "Undecided", "Agree" and "Strongly Agree". The collected data were transferred to the Statistical Program for Social Sciences (SPSS) v.25 and processed. The Independent Samples Test analysis was used to analyse whether there were differences between students' attitudes regarding-

[8] Professor at "Ukshin Hoti" University
[9] School Principal, PhD candidate

përdorimit të mjeteve elektronike, është përdorur analiza Independent Samples Test. Ndërsa, për të analizuar se a ekzistojnë dallimet ndërmjet qëndrimeve të studentëve lidhur me mësimin online dhe programit të studimeve nga analiza ANOVA, është përdorur testi Post-hoc (Bonferroni).

Përfundimet e dala nga analizat e realizuara tregojnë se mesatarja e pikëve të qëndrimeve është 3.04, domethënë ato janë në distancë pothuajse të afërta nga dy skajet e kundërta (pozitive dhe negative). Gjithashtu, nuk ka dallime të rëndësishme të qëndrimeve të studentëve lidhur me mësimin online ndërmjet gjinive, vendbanimit të studentëve, përdorimit të mjeteve elektronike, si dhe programit të studimeve.

**Fjalët çelës:** studentët, qëndrimet, qasja, mësimi online

online learning gender, student residence, and the use of electronic tools. Whereas to analyse whether there are differences between students' attitudes regarding online learning and the study program from the ANOVA analysis, the Post-hoc test (Bonferroni) was used.

The conclusions from the analysis show that the average of the mean is 3.04, i.e., they are approximately identical to the two opposite positions (positive and negative). Finally, there are no significant differences in student attitudes on the online learning between genders, student locality, the use of electronic devices, and the study program.

**Keywords:** students, attitudes, approach, online learning

**Descriptive Statistics**

| | N | Minimum | Maximum | Sum | Mean | Std. Deviation | Variance | Skewness | | Kurtosis | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Statistic | Statistic | Statistic | Statistic | Statistic | Statistic | Statistic | Statistic | Std. Error | Statistic | Std. Error |
| Shuma | 254 | 1.55 | 4.75 | 774.35 | 3.0486 | .40665 | .165 | .140 | .153 | 3.511 | .304 |
| Valid N (listwise) | 254 | | | | | | | | | | |



**Seanca 3: Mësimdhënia dhe arritjet e nxënësve**
**Session 3: Teaching and student achievement**
**Moderatore: Haxhere Zylfiu**

## Roli i prindërve në përmirësimin e cilësisë në mësimnxënie kundrejt mësimdhënies bashkëkohore

Besjana Rexhepi, PhD. Cand.
Universiteti "Kadri Zeka", Gjilan
Email: besjana.rexhepi@uni-gjilan.net
Orcid ID: 0000-0001-8979-7543

### Abstrakt

Nisur nga fakti se fillet e edukatës nisin pikërisht në familje, si institucioni më i vjetër i shoqërisë njerëzore, padyshim se roli i prindërve është i pashmangshëm në shumë çështje që lidhen edhe me përmirësimin e cilësisë në procesin e mësimnxënies së nxënësve, si bashkëpunëtorë përgjatë mësimdhënies bashkëkohore.

Sot prindërit nuk mund të quhen vetëm partnerë të jashtëm për procesin mësimor, por dhe indikatorë për sukseset dhe dështimet e nxënësve në shkollë.

Lidhur me këtë, pjesë e punimit tonë do të jenë përshkrimi i rolit të prindërve në aspektin e

## The Role of Parents in Improving the Quality of Learning towards Contemporary Teaching

Besjana Rexhepi, PhD. Cand.
"Kadri Zeka" University, Gjilan
Email: besjana.rexhepi@uni-gjilan.net
Orcid ID: 0000-0001-8979-7543

### Abstract

The role of parents is unavoidable in many issues related to improving the quality of the learning process of students, as partners in contemporary teaching, given the fact that the origins of education start precisely in the home, as the oldest institution of human society.

